



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

2011

RAPORT VJETOR



SEMPER VIGILE

GJITHMON VIGJILENT

Inspektorati Policor i Kosovës



Raport Vjetor

2011


Qeveria e Kosovës



Ministria e Punëve të Brendshme

2011

Inspektorati Policor i Kosovës



**Rr. "Tirana" p.n
10000, Prishtinë
038 521 201 / 19 691
030 521 149/19 702
info.ipk@rks-gov.net
www.ipk.rks-gov.net**

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme;
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës;
PK	Policia e Kosovës;
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ARTC	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Advokim
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
KEEP	Kodi Evropian i Etikës Policore;
UE	Unioni Evropian;
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSO	Procedura Standarde të Operimit;
DPP	Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA

I.	Fjala hyrëse e Ministrit të Punëve të Brendshme.....	6
II.	Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv.....	8
III.	Hyrja.....	9
IV.	Mandati dhe misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës.....	10
V.	Struktura Organizative e IPK-së.....	11
VI.	Sfidat dhe aktivitetet kryesore të IPK-së gjatë vitit 2011.....	12
	a) Departamenti i Hetimeve.....	13
	b) Departamenti i Inspektiveve.....	19
	c) Departamenti i Testit të Integritetit.....	20
	d) Departamenti i Analizes së Informacionit dhe Menaxhimit të Ankesave.....	20
	e) Departamenti i Administratës.....	21
VII.	Bashkëpunimi vendor, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun.....	23
	a) Bashkëpunimi me ICITAP.....	23
	b) Bashkëpunimi me OSBE.....	25
	c) Bashkëpunimi me SHKB.....	26
	d) Bashkëpunimi me EULEX.....	27
	e) Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Policinë.....	27
	f) Bashkëpunimi me ARTC-në (Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Advokim).....	28
	g) Marrëdhëniet me mediat dhe publikun.....	28
VIII.	Përmbledhje.....	30

I. FJALA HYRËSE E MINISTRIT



Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme është që përmes mekanizmave të zbatimit të ligjit të kujdeset për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në përgjithësi. Rezultatet e punës tonë ndikojnë, jo vetëm në jetën e përditshme të qytetarëve të vendit, por gjithashtu edhe në perspektivën e integriteteve evropiane të shtetit tonë. Së këndejmi, nuk ka instrument më të rëndësishëm se sa zhvillimi i mekanizmave të zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrjes demokratike të këtyre mekanizmave, me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftë kundër krimit dhe dukurive negative në vend, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të secilit individ.

Kultivimi i parimit themelor për kontrollin demokratik të këtyre Institucioneve është jetik në reformimin e sektorit të sigurisë në çdo vend demokratik. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme konsideron se ka ndërtuar mekanizma demokratik për luftimin e keqpërdorimit dhe tejkalimit të autorizimeve dhe mandatit të zyrtarëve policor. Tanimë, ne kemi një Institucion i cili është funksional dhe në përputhje me mandatin ligjor është duke i dhënë rezultatet e para të punës, me ç'rast dëshiroj të shpreh vlerësimin e lart për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar nga menaxhmenti dhe stafi i IPK-së.

Ky raport prezanton aktivitetet e IPK-së gjatë vitit 2011 duke u fokusuar në progresin e arritur dhe sfidat të cilat duhet adresuar me qëllim të vazhdimit të ngritjes së një organizate Policore efektive dhe efikase. Sukseset kryesore gjatë vitit 2011 ndërlidhen me transformimin e IPK-së në aspektin funksional dhe organizativ, bartjen e përgjegjësisë nga niveli i ndjekjes disiplinore në nivel të ndjekjeve penale si dhe ristrukturimin organizativ nga një strukturë organizative me dy departamente dhe 50 punonjës, në një strukturë organizative me 5 departamente dhe 92 punonjës të paraparë.

Po ashtu, gjatë vitit 2011, IPK-ja ka nisur inspektime në fusha të caktuara me qëllim të vlerësimit të performancës së Policisë së Kosovës, duke ofruar rekomandime për përmirësimin e tyre. Të gjitha këto inspektime dhe rekomandimet e nxjerra do të jenë shumë kërkuese nga aspekti i përmirësimeve të cilat duhet të zbatohen. Zbatimi i tyre do të jetë një nga prioritetet kryesore të menaxhmentit të Policisë së Kosovës, prandaj me të drejtë presim që Policia e Kosovës shumë shpejt të demonstrojnë rezultatet e para tek partnerët tanë, bartësit e interesit, shoqërisë civile dhe qytetarëve të vendit me qëllim të jetësimit të përkushtimit tonë për të

ndërtuar një vend dhe shoqëri ku sundon ligji të bazuar në vlerat demokratike dhe institucionale të vendeve të zhvilluara perëndimore.

Një Inspektorat Policor funksional dhe i përkushtuar për punë vetëm se do të ndikojë në një punë më profesionale të Policisë dhe nuk duhet të shihet si një mekanizëm i dhunës. Së këndejmi ftoj të gjithë qytetarët e vendit të bashkëpunojnë me Inspektoratin Policor të Kosovës, duke shprehur njëkohësisht besimin se bashkërisht do të vazhdojmë me një angazhim të shtuar në drejtim të përmirësimit të performancës së Policisë së Kosovës, në bazë të standardeve dhe praktikave më të avancuara ndërkombëtare duke u ndjekur nga parimet e profesionalizmit, transparencës dhe mos diskriminimit.

Bajram Rexhepi

Ministër i Punëve të Brendshme

II. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



Kam kënaqësinë t'i paraqes publikut raportin vjetor te Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për vitin 2011. Raporti ofron informacione të rëndësishme për misionin dhe objektivat e realizuara nga ana e IPK-se, si Agjension i pavarur i zbatimit të ligjit, reformat rrënjësore të ndërmarra këtë vit dhe ilustrime të tjera në aspektin organizativ.

IPK-ja, tani më është Agjension i konsoliduar, tërësisht i pavarur nga Policia, e cila përveç inspektimeve të strukturave dhe funksioneve policore, ka kompetencë edhe për të parandaluar, hetuar, zbuluar e dokumentuar veprat penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose

jashtë saj.

Ne do të jemi çdo here të vetëdijshëm, se duke qenë një institucion i pazëvendësueshëm në rritjen e integritetit të Policisë sonë, lufta kundër korrupsionit në radhët e policisë të jetë prioriteti ynë kryesor duke u kujdesur që askush në Policinë e Kosovës të mos jete imun ndaj shkeljeve ligjore. Inspektorati Policor i Kosovës, duke kryer me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e saj, ka për qëllim parësor, ta ndihmojë Policinë e Kosovës që ta përmbush misionin e tij ligjor, në harmoni me ligjet në fuqi dhe standardet e kërkuara, dhe t'ju ofroj qytetarëve një polici të përgjegjshme, profesionale dhe efektive .

Inspektorati Policor i Kosovës, do të vazhdojë të ketë bashkëpunim të ngushtë edhe me organizatat tjera vendore e ndërkombëtare që zbatojnë ligjin në Kosovë, siç janë: ICITAP, OSBE, EULEX etj, për rolin e tyre në rritjen e performancës dhe trajnimet e ofruara nga ekspertet e tyre.

Ne do të udhëhiqemi çdo here nga parimi se, çështjet të cilat janë objekt hetimi apo inspektimi, ti trajtojmë me profesionalizëm, objektivitet, pa anshmëri dhe duke respektuar çdo herë parimet kushtetuese për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. IPK-ja do të punoj në vazhdimësi në ruajtjen e besimit të qytetarëve, duke qenë të vendosur për ta hetuar çdo ankesë që na drejtohet për çdo shkelje të kryer nga punonjësit e policisë, për të cilën në kemi kompetencë.

Ne falënderojmë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar IPK-në në realizimin e synimeve të saj të parapara me ligj. IPK në vazhdimësi do të kujdeset që ta përmirësojë mekanizmin e vetë të kontrollit të brendshëm me qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit.

Fitim Shishani

Kryeshef Ekzekutiv

Inspektorati Policor i Kosovës

III. HYRJE

Ky është raporti përmbledhës i punës së Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për periudhën Janar - Dhjetor 2011 ku do të prezantohen aktivitetet e ndërmarra nga agjencioni bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi, të arriturat kryesore gjate kësaj periudhe, vështirësitë në arritjen e objektivave tona strategjike dhe sfidat që e presin organizatën në periudhën në vazhdim.

Pjesa e parë e këtij raporti do të përmbledh mandatin dhe misionin e IPK-së ndërsa në pjesën e dytë do të përmbledhen sfidat kryesore gjatë vitit 2011 dhe do të vazhdoj me aktivitetet e IPK-së gjatë po atij viti. Pjesa përfundimtare e këtij raporti do të përmbledh objektivat dhe aktivitetet e vitit 2012 që janë planifikuar të realizohen. Ky raport do të përmbaj aktivitete dhe të arritura të dokumentuara.

Në vitin që lamë pas, IPK-ja i është nënshtruar një transformimi, si në aspektin funksional, po ashtu edhe në atë organizativ. Aspekti funksional lidhet me atë se tani në kuadër të funksioneve të agjencisë kemi një fuqizim të kompetencave inspektuese në fushën e inspektimeve të menaxhimit policor, si dhe një ndryshim rrënjësor të kompetencave të agjencisë në lëmin hetimeve, meqë nga dhjetori i vitit 2010, IPK-ja merret me hetimin e veprave me karakter penal, për dallim nga vitet e kaluara kur legjislacioni e kishte ngarkuar me kompetenca në hetimin e shkeljeve disiplinore të supozuara, të kryera nga punonjësit policorë.

Në aspektin organizativ duhet potencuar se ka ndryshuar edhe organizimi i brendshëm i organizatës, si rezultat i funksioneve dhe nevojave për zbatimin e mandateve të reja ligjore. Me strukturën e re të organizimit kemi një shtim të numrit të departamenteve si pjesë e strukturës operative të agjencisë dhe tani IPK funksionon me pesë (5) departamente, prej të cilave katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës.

Departamentet operative që ushtrojnë funksionet hetues dhe inspektues janë: Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektimeve, Departamenti i Testit të Integritetit dhe Departamenti për Analizimin e Informacionit dhe Menaxhimin e Ankesave, kurse Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse ushtron aktivitet mbështetës në funksion të departamenteve operative.

IV. MANDATI DHE MISIONI I INSPEKTORATIT POLICORË TË KOSOVËS

IPK-ja funksionon si agjencion ekzekutive në kuadër të MPB-së që nga viti 2006. Me ndryshimet e arritura në Ligjin e IPK-së të hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2010 (03/L-231), agjencioni ka fuqizuar rolin e vet në fushën e inspektimeve në Policinë e Kosovës, kurse ka ndryshuar tërësisht objektin e veprimtarisë hetuese.

Sipas Ligjin për IPK-n (03/L-231), agjencioni jonë, kombinon dy funksione primare në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës si shtyllat kryesore të një policie demokratike:

- Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.
- Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës (PK) për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi.

Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.


IPK-ja, është e frymëzuar dhe kërkon që të vërteton pajtueshmërinë e policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore si një kornizë e standardeve për kryerjen e detyrave policore në mënyrë demokratike.

IPK-ja, duke ushtruar autorizimet ligjore, do të jetë kontribuuese e arritjes së tri qëllimeve:

- *efektshmërisë*, duke u siguruar që qëllimet e policisë janë arritur;
- *pajtueshmërisë*, duke u siguruar që ato qëllime janë arritur në pajtueshmëri të plotë me ligjet e aplikuara dhe standardet evropiane;
- *zotësisë*, duke u siguruar që qëllimet e PK-së janë arritur në mënyrën më fitimprurëse, duke ua bërë të ditur taksapaguesve, punën e policisë.

V. STRUKTURA ORGANIZATIVE E IPK-së

Tanimë organizata ka të aprovuar një strukturë të re organizative, e cila është dizajnuar duke u mbështetur në funksionet bazë të agjencisë dhe mandatin e saj. Në bazë të Udhëzimit Administrativ që rregullon strukturën e organizimit të brendshëm të IPK-së, agjencia është e strukturuar në departamente të cilat kanë një ndarje sektoriale.



Struktura e organizimit të agjencisë përbëhet nga katër nivele, të cilat pasqyrojnë nivelet e organizimit, drejtimit, kontrollit dhe zbatimit. Niveli më i lartë i hierarkisë udhëheqëse është “niveli i lartë menaxherial ekzekutiv” që përfaqësohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i cili sipas Ligjit për IPK-në është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të IPK-së dhe autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i IPK-së.

“Niveli i dytë i menaxhimit” përfaqësohet nga departamentet, me të cilët udhëheqin drejtorët e departamenteve.

Departamentet kanë edhe ndarjen sektoriale, që paraqet “nivele të parë të menaxhimit” të përfaqësuar nga sektorët e të cilët udhëhiqen nga shefat e sektorëve. Vlerësohet se për një periudhë të shkurtër të plotësohet struktura ashtu siç e parasheh edhe organogrami i aprovuar nga Ministri.

VI. SFIDAT DHE AKTIVITETET KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2011

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri për IPK-në ka shtruar nevojën e nxjerrjes së udhëzimeve administrative të cilat kanë paraqitur nevojën e themelimit të grupeve punuese të caktuara në kuadër të agjencisë dhe Ministrisë, të cilat kanë qenë të rëndësishme jetike për zhvillimin aktiviteteve të IPK-së në zbatimin e mandateve ligjore.

Gjatë punës së këtyre grupeve punuese janë nxjerr dymbëdhjetë (12) udhëzime administrative të cilat janë aprovuar nga Ministri dhe kjo ka bërë që agjencia të kompletojë në masë të duhur rregullativën e saj ligjore.

Nxjerrja e udhëzimeve të reja administrative ka nxjerr sfidën e radhës në sigurimin e resurseve të nevojshme njerëzore dhe materiale në zbatimin e këtyre udhëzimeve. P.sh. nga një strukturë në përbërje prej dy departamenteve me 50 punonjës, IPK-ja sipas Udhëzimit Administrativ për Strukturën Organizative ka kaluar në një strukturë me pesë departamente me 92 punonjës. Tani mungesa e fuqisë punëtore është një ndër pengesat kryesore në arritjen e rezultateve.

Sa për ilustrim, Departamenti i Inspektiveve sipas strukturës ka 22 punonjës, ndërsa tani ka vetëm 8 punonjës, kurse Departamenti i Hetimeve duhet të ketë 35 punonjës ndërsa tani ka vetëm 17 punonjës. Përmeshja e kësaj strukture kërkon kosto buxhetore dhe investime në përgatitjen dhe zhvillimin e personelit të ri me kompetencën e duhur profesionale.

Në ballafaqim me këtë sfidë, kemi arritur që fillimisht të përzgjedhim drejtorët e departamenteve bazë dhe të identifikojmë forma alternative të rekrutimit të personelit derisa të sigurohen mjetet financiare për rekrutimin e stafit të nevojshëm si dhe të sigurojmë edhe disa pajisje pune përmes donacioneve dhe formës së huazimit ndër institucional.

Ndryshimet dhe fuqizimi i agjencisë në fushën e kompetencave ka shtyrë menaxhmentin e IPK-së që të mobilizohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale edhe të burimeve njerëzore ekzistuese të cilat për shkak të këtyre ndryshimeve ishte paraqitur nevoja e trajnimeve të reja konform kompetencave të reja.

Përmes bashkëpunimit me organizatat e ndryshme partnere, vendore e ndërkombëtare, kemi arritur që gjatë kësaj periudhe të pajisim stafin tonë me trajnimet bazike për të arritur që të përmeshin kërkesat themelore të mandateve të dala nga ligji për IPK-në.

Duke e konsideruar si vit të ndryshimeve për shkak të ndryshimit të kompetencave dhe funksioneve, menaxhmenti është përkushtuar edhe në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale të strukturës operative të agjencisë. Inspektorët dhe hetuesit kanë ndjekur një numër të konsideruar të trajnimeve, si në vijim:

- Intervistimi dhe teknikat e marrjes në pyetje (ICITAP),
- Trajnimi në Programin ndërkombëtar për sundim të ligjit (ICITAP),
- Kursi themelor i hetimeve penale (ICITAP),
- Trajnimi i menaxhimit të projekteve (OSBE),
- Taktikat mbrojtëse (QKSPEZH),
- Trajnim bazik me pistoletë 'Glllok 19' (QKSPEZH),
- Zhvillimi i planifikimit strategjik (OSBE),
- Procesi bazik i inspektimit (ICITAP),
- Trajnimi kundër korrupsionit (OSBE), dhe
- Teknikat e analizës financiare (ICITAP)

Departamentet e IPK-së të pajisur me këto kompetenca kanë arritur rezultate solide në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre të cilat do të paraqesim në vijim:

a) Departamenti i Hetimeve;

Për periudhën janar-dhjetor 2011, IPK-ja ka pranuar gjithsej 649 ankesa të qytetarëve ndaj zyrtarëve policorë në lidhje me shkelje disiplinore. Pas analizimit dhe klasifikimit të ankesave, IPK-ja të njëjtat i ka proceduar për hetim disiplinor pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës.

Pas zbatimit të hetimeve penale nga ana e IPK-së ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës, nga muaji qershor deri në muajin dhjetor të 2011, IPK-ja ka

regjistruar gjithsej 143 lëndë të karakterit penal, në lidhje me vepra të ndryshme penale, të cilat supozohet se janë kryer nga zyrtarët policorë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo edhe jashtë saj.

Nëse i bëjmë një vështrim numrit të lëndëve për çdo muaj, shihet se muaji dhjetor ka qenë muaji me numrin më të madh të lëndëve të regjistruara, gjithsej 30 që i atribuohet fushatës së vetëdijshmit qytetarë të cilin e kishte ndërmarr IPK-ja gjatë këtij muaji, deri sa muaji me numrin më të vogël të lëndëve të regjistruara ka qenë muaji tetor, me gjithsej 9 lëndë (shih tabelën 1)



Drejtori i Departamentit të Hetimeve gjatë një trajnimi të Hetuesve të IPK-së

Tabela 1: Paraqitja tabelare lëndëve të regjistruara për vepër penale (qershor-dhjetor 2011)	
Muaji	Numri i rasteve penale
Qershor	16
Korrik	22
Gusht	22
Shtator	20
Tetor	9
Nëntor	24
Dhjetor	30
Gjithsej	143

Departamenti i Hetimeve ka pranuar shtatë (7) raste për hetim disiplinor, dy (2) prej të cilave janë në hetim e sipër, dy (2) raste janë në hetim preliminar, për një (1) rast është pezulluar hetimi (për shkak se është në Prokurori) dhe për dy (2) raste janë pushuar hetimet disiplinore (shih tabelën 2).

Tabela 2: Paraqitja tabelare e rasteve disiplinore (janar-dhjetor 2011)				
Në hetim	Hetim preliminar	Hetim i pezulluar	Pushim i hetimit	Gjithsej
2	2	1	2	7

Për periudhën kohore qershor-dhjetor 2011, IPK-ja ka ngritur gjithsej 46 kallëzime penale në prokuroritë kompetente, ndërsa 18 lëndë janë dërguar në Prokurori me 'raport të veçantë', pasi që nuk ka pasur dyshim të bazuar për ngritjen e kallëzimit penal, pesë (5) raste janë dërguar në Gjykata për Kundërvajtje, tetë (8) raste janë mbyllur në IPK, pas hetimit preliminar, tetë (8) raste janë mbyllur pa u hapur hetimet penale në konsultim me prokurorët kompetent. Këtu kemi të bëjmë me raste kur ndiqen me padi private jo 'sipas detyrës zyrtare' edhe disa raste kur Prokurori ka sugjeruar që rasti të hetohet për shkelje administrative (disiplinore), për shkak të mos ekzistimit të elementeve të veprës penale. Ndërsa kemi edhe 58 raste që janë në proces të hetimit në IPK (shih tabelën 3).

Tabela 3: Paraqitja tabelare e statusit të lëndëve (qershor- dhjetor 2011)						
Kallëzime penale	Dërguar në Prokurori me raport të veçante	Dërguar në Gjykatë për kundërvajtje	Lëndë të mbyllura në IPK	Të tjera	Ne hetim	Gjithsej
46	18	5	8	8	58	143

Janë ngritur gjithsej 46 kallëzime penale në prokuroritë kompetente, prej të cilave, 36 në prokuroritë komunale dhe dhjete (10) në prokuroritë e qarkut. Pas ngritjes së kallëzimeve penale, dy (2) prej tyre janë hedhur poshtë (pushuar hetimi), një (1) nga Prokuroria Komunale dhe një (1) nga Prokuroria e Qarkut. Për tetë (8) kallëzime penale janë ngritur pesë (5) aktakuza në gjykatat komunale dhe tre (3) në gjykatat e qarkut. Për tetë (8) aktakuza të ngritura, deri më tani kemi vetëm një të dyshuar të shpallur fajtor nga gjykata. Tani janë 36 kallëzime penale në shqyrtim tek prokurorët kompetent, ku prej tyre, 30 në prokuroritë komunale dhe gjashtë (6) në prokuroritë e qarkut (*shih tabelën 4*).

Tabela 4. Paraqitja tabelare e lëndëve në bazë të Prokurorive dhe Gjykatave (qershor-dhjetor 2011)			
Prokurori Komunale	Prokurori e Qarkut	Gjykatë Komunale	Gjykatë e Qarkut
36	10	5	3

Sipas të dhënave statistikore të IPK-së, si të dyshuar për veprë penale janë duke u hetuar 157 pjesëtarë të Policisë së Kosovës të gjinisë mashkullore si dhe tetë (8) të gjinisë femërore. Kurse sa i përket përkatësisë së tyre etnike, del se 147 janë me përkatësi shqiptar, 16 serb, 1 boshnjak dhe 1 turk. Nga 16 serb, 13 janë nga Regjioni i Mitrovicës. Në veprimtari penale gjithsej kemi të përfshirë 165 zyrtarë policorë dhe 16 qytetarë. Kurse, si vepra penale më të shpeshta prinë 'rrezikimi i trafikut publik' me 21 raste, 'lëndim i lehte trupor' me 19 raste, 'shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit' me 18 raste, 'marrja e ryshfeti' me 15 raste, 'keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare' me 10 raste, si dhe rastet tjera me numër më të vogël (*shih tabelën 5*).

Tabela 5: Paraqitja tabelare e rasteve dhe personave të përfshirë, sipas klasifikimit të veprave penale (qershor-dhjetor 2011)		
Klasifikimi i veprës penale në IPK	Numri i përgjithshëm i rasteve	Numri i personave të përfshirë
Rrezikim i trafikut publik	21	21
Kanosje	14	15
Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare	10	10
Shtrengim	1	1
Lëndim i lehtë trupor	19	19
Falsifikim i parase	1	1
Dhunim	1	2
Përvetësim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	1	1
Dhënia e ndihmës kryerësve të veprës penale pas kryerjes së veprës penale	4	4
Ndërprerja e pa lejuar e shtatzënisë	1	1
Mosdhënja e ndihmës	2	4
Vrasje	1	1
Kontraktimi i fitimit jo-proporcional	1	1
Dëmtim i pasurisë së palujtshme	1	2
Marrja e rryshfetit	15	15
Mashtrim	3	3
Privim i kundërligjshëm nga liria	3	8
Ushtrim arbitrar i të drejtave	1	1
Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	18	18
Falsifikim i dokumentave	1	1
Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	4	4

Moslajmërimi i veprës penale	3	3
Trafikim me njerëz	1	1
Mundësi prostitucioni	1	1
Rrëmbim i personit	1	4
Mbajtje në pronësi, kontroll në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve	5	5
Deklarim i rrejshëm	2	2
Marrja e deklaratës me anë të shtrëngimit	2	2
Vjedhje	4	4
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	2	2
Lëndim i rëndë trupor	1	1
Dhënia e rryshfetit	1	1
Nxitja në rrezik të përgjithshëm	1	1
Keqpërdorim i detyrës zyrtare	3	3
Kidnapim	1	1
Aksident me lëndime të rënda trupore	1	1
Falsifikim	1	1
Kontrabandim	2	2
Shpërdorim seksual	1	1
Sulm ndaj personit zyrtar në kryerje të detyrës zyrtare	1	1
Zbulim i fshehtësive zyrtare	1	1
Dhuna në familje	2	2
Dëmtim prone	3	3
Blerje, posedim, transportim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e lëndëve narkotike dhe substancave psikotropike	1	1

Në bazë të statistikave vetëm që nga qershori 2011 janë trajtuar 28 raste të korrupsionit (Marrje ryshfeti, keqpërdorim i detyrës zyrtare), janë arrestuar katër (4) zyrtarë policorë, në Prokurori kanë shkuar 7 kallëzime penale, me raport të veçantë 3 raste, kurse janë duke u trajtuare apo në hetim e sipër edhe 16 raste të kësaj natyre.

Për një periudhë të shkurtër kohore, IPK-ja ka arritur të tregojë seriozitetin e saj dhe përkushtimin për luftimin e dukurive negative e veçanërisht të korrupsionit.

Inspektorati Policor i Kosovës, nga muaji qershor i vitit 2011, e deri në dhjetor të vitit 2011, ka arrestuar gjithsej 15 zyrtarë policor të cilët kanë qenë të përfshirë në vepra të ndryshme penale. Po ashtu IPK-ja gjatë kohës sa ka qenë duke i hetuar rastet për veprimtari penale, i ka rekomanduar Drejtoritë të Përgjithshëm të Policisë shtatë rekomandime për suspendim me pagesë të zyrtarëve policor, deri në përfundim të hetimeve penale.

Zyrtarë policorë të Arrestuar nga IPK-ja	Të Suspenduar me rekomandim të IPK-së
15	7

Tre (3) zyrtarë policor janë të arrestuar nën dyshimin se kanë kryer veprën penale “Kidnapim”, 3 (tre) zyrtarë policor janë të arrestuar për veprën penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit” dhe për veprën penale “Marrja e ryshfetit”, 2 (dy) janë të arrestuar për veprën penale “Përdorimi paautorizuar i armëve” dhe “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, 2 (dy) për veprën penale “Rrezikim i trafikut publik - Aksident komunikacioni me fatalitet”, 1 (një) zyrtarë policor është arrestuar për veprën penale të “Vrasje”, 1 (një) është arrestuar për “Shpërdorimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, 1 (një) është arrestuar në lidhje me veprën penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, 1 (një) zyrtarë policor është arrestuar për veprën penale “Dhuna në familje”, si dhe 1 (një) zyrtarë policor është arrestuar në dyshimin se ka kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” dhe “Ndërprerje e palejuar e shtatzënisë”.

Ndërsa sa i përket rekomandimeve për suspendim të zyrtarëve policor të cilët janë duke u hetuar nga IPK-ja në lidhje me implikimin e tyre në vepra penale, Inspektorati Policor i Kosovës Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës i ka rekomanduar gjithsej 7 rekomandime për suspendim, të PK-së, deri në përfundimin e hetimeve penale nga ana e Inspektoratit Policor të Kosovës.

b) Departamenti i Inspektimeve;

Aprovimi i Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës ka pasur për rrjedhojë edhe nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Inspektime në Policinë e Kosovës, por edhe të Doracakut “Procedurat Standarde të Operimit për Inspektime në Policinë e Kosovës”.

Po ashtu, pas ndjekjes së dyzetë (40) orëve trajnuese, inspektorët janë certifikuar nga ICITAP-i në një “kurs bazik për inspektime”, si dhe po nga e njëjta organizatë kanë ndjekur një trajnim njëditor mbi “Ngacmimin seksual dhe armiqësinë në mjediset punuese”.



Drejtori i Departamentit të Inspektimeve gjatë një trajnimi me stafin e IPK-së në ambientet e ICITAP-it

Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, roli dhe misioni i këtij Departament është që të zhvillojë inspektime ndaj Policisë së Republikës së Kosovës dhe të raportojë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të menaxhmentit të saj, dhe të japë rekomandimet e saja lidhur me efikasitetin, efektivitetin dhe pajtueshmërinë e punës policore me ligjet në fuqi, si dhe identifikimin dhe parandalimin e çfarëdo devijimi nga aktet ligjore dhe procedurat me të cilat funksionon Policia e Kosovës.

Përmes procesit të inspektimit bëhet vlerësimi i mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke:

- Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj organizative;
- Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së Policisë së Kosovës;
- Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të Policisë së Kosovës.

Në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga legjislacioni për të ushtruar mbikëqyrje të përhershme mbi punën e organizatës policore, Departamenti i Inspektimeve ka bërë përgatitjet për funksionalizimin e një numri inspektimesh në Policinë e Kosovës.

Identifikimi i fushave policore është bazuar në rëndësinë e programeve/fushave policore, ndjeshmërinë e kompleksitetin e saj, riskun e identifikuar, frekuencën e inspektimit dhe nevojën e organizimit në kohën kur institucionet relevante kanë shtuar përpjekjet për ngritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave.

Në vazhden e aktiviteteve të saj gjatë kësaj periudhe Departamenti i Inspektimeve është në proces të dy inspektimeve në Policinë e Kosovës.

c) Departamentet i Testit të Integritetit

Bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon fushëveprimtarinë e agjencisë, IPK-ja ka të drejtë të kryejë hetimin e integritetit të punonjësve të Policisë së Kosovës. Këtë aktivitet agjencia do ta kryejë përmes të Departamentit të Testit të Integritetit, departament ky i ngritur në kuadër të strukturës së organizimit të brendshëm të saj.

Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Testit të Integritetit është “hetimi i integritetit i cili ka për qëllim të zhvillojë kapacitetin pro-aktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit në kuadër të standardeve të larta profesionale brenda Policisë së Kosovës, duke kontribuar në përpjekjet mbi kontrollin e korrupsionit, duke rritur cilësinë e shërbimit dhe rritjen e besimit të publikut ndaj Policisë”.

Tani jemi duke përgatitur projektin për funksionalizimin e departamentit dhe pritet që edhe kjo pjesë e strukturës operative hetuese të operacionalizohet.

d) Departamenti për Analizën e Informacioneve dhe Menaxhimin e Ankesave

Departamenti për Analizën e informacionit dhe menaxhimin e ankesave është një departament i ri i cili ka dalur si rezultat i strukturës së re organizative e miratuar pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të Inspektoratit Policorë të Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësit e këtij departamenti do të jenë në analizimin e informatave dhe menaxhimi i ankesave të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e mundshme të rregullave dhe procedurave të PK-së si dhe ligjeve të Republikës së Kosovës nga pjestarët e Policisë pa dallim grade apo pozite.

Ky departament është në proces të themelimit duke përgaditur rregullativen e mbrendshme të këtij departamenti si dhe duke përgatitur kuadrot e nevojshëm me njohuri të nevojshme profesionale për ti angazhuar në këtë departament.

e) Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse (DASHM) të IPK-së kryen të gjitha punët administrative dhe ka rol mbështetës në mbarëvajtjen e punëve të agjencisë.

Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse u ofron departamenteve operative mbështetje materiale, logjistike, teknike.

Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse përkujdeset për fushat, si:

- buxheti dhe financat,
- personeli,
- prokurimi,
- teknologjia informative,
- transporti dhe
- logjistika.

Agjencioni jonë ka shpenzuar buxhetin në shkallën 91.45%. Këto të dhëna janë prezentuar edhe në mënyrë tabelore në pasqyrën e shpenzimeve buxhetore, sipas kategorive ekonomike (*shih tabelën 6*).

Tabela 6: Buxheti i alokuar dhe i shpenzuar (janar-dhjetor 2011)				
Kategoria ekonomike	Buxheti i alokuar	Buxheti i shpenzuar	Ndryshimi	(%)
Paga e mëditje	295,899.00	280,311.62	15,587.38	94.73
Mallra e shërbime	240,254.28	209,205.74	31,048.54	87.08
Komunalitë	11,000.00	10,935.72	64.28	99.42
Investime kapitale	0,00	0,00	0,00	0,00
Gjithsej	547,153.28	500,453.08	46,700.20	91.46




Fig. 2. Diagrami i buxhetit të alokuar dhe të shpenzuar

Për shkak të ndryshimeve të reja në strukturën organizative të IPK-së, ne për vitet e ardhshme do të kemi nevoja të mëdha për rritje të buxhetit aktual i cili është i paraparë për një staf prej 50 punonjësve ndërsa synimet tona për implementim të Udhëzimit Administrativ për Strukturën Organizative të IPK-së kërkojnë 92 punonjës.

Nevojat e ardhshme të IPK-së për të arritur këto synime kërkojnë edhe rritjen e kostos buxhetore për Paga dhe Mëditje, Shërbime dhe Mallra, Shpenzime Komunale si dhe Shpenzime Kapitale.

Kërkesa më urgjente të cilat ka IPK-ja për të përmbushur mandatet e saja është që të siguroj akomodimin e stafit me një objekt që përmbush kushtet e domosdoshme të punës, sigurimin e veturave për kryerjen e aktiviteteve të përditshme të punës si dhe furnizimin me pajisjet e nevojshme si armë, pajisje vëzhgimi, pajisje të TI-së etj.

VII. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT ME ORGANIZATAT VENDORE E NDËRKOMBËTARE



Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së me drejtorët e departamenteve të IPK-së dhe përfaqësuesit e OSBE, EULEX dhe ICITAP.

Zhvillimi i marrëdhënieve me organizatat partnere dhe me publikun është i rëndësishëm thelbësor për IPK-në. Gjatë këtij viti, IPK-ja ka pasur një mori aktivitete në vazhdim të përpjekjeve për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me qytetarë dhe partnerë të ndryshëm, me organizata qeveritare e jo qeveritare dhe me media.

a) Bashkëpunimi me ICITAP-in

Marrëdhëniet me ICITAP-in janë të natyrës këshillëdhënëse dhe mbështetëse, nga të cilat IPK-ja ka dobi në aspektin këshillëdhënës, në ofrimin e trajnimeve dhe donacioneve. Kjo organizatë edhe këtë vit ka mbështetur agjencinë tonë në shumë fusha.

Në drejtim të ofrimit të mbështetjes në nxjerrjen e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në, kontributi i kësaj organizate ka qenë prioritar dhe i pa zëvendësueshëm. Ekspertët e kësaj organizate kanë qenë pjesë e grupeve punuese në nxjerrjen e udhëzimeve administrative.



ICITAP-i ka ofruar për agjencinë tonë një numër trajnimesh të cilat kanë ngritur kapacitetet profesionale të punonjësve tanë, si: "Trajnimi mbi teknikat e marrjes në pyetje dhe

intervistimit”, “Kursi bazik i hetimeve penale”, “Trajnimi themelor mbi procesin e inspektimit”, “Teknikat e analizës financiare” dhe “Ngacmimi seksual dhe armiqësia në punë”.

Po ashtu, ICITAP-i ka sponsoruar pjesëmarrjen e dy punonjësve të Departamentit të Inspektiveve dhe Hetimeve në Akademinë Ndërkombëtare për Forcimin e Sundimit të Ligjit (ILEA), në Budapest të Hungarisë. Në këtë trajnim dy (2) mujor pjesëmarrës ishin edhe një numër punonjësish nga Policia e Kosovës, Policia Hungareze, Policia e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ajo e Kroacisë.

Me rastin e organizimit të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga data 19-27 tetor të vitit 2011, në të cilën kanë marrë pjesë një numër drejtorësh të Policisë, ICITAP-i i ka ofruar mbështetje agjencisë duke i mundësuar Kryeshefit Ekzekutiv që të jetë pjesë e kësaj ngjarjeje.

Mbështetja e ICITAP-it për IPK-në ka qenë e orientuar veç tjerash edhe në ofrimin e “pajisjeve teknike për vëzhgim” për të përforcuar kapacitetet teknike në luftimin e korrupsionit dhe keq menaxhimit policor. Me këtë rast, kjo organizatë i ka ofruar IPK-së një donacion pajisjesh për punë në terren të strukturës hetuese. Po ashtu vlen të cekët edhe donacioni nga kjo organizatë i bazës së të dhënave apo “sistemit për menaxhimin e rasteve”.

ICITAP ka treguar gatishmëri të plotë në mbështetjen e vazhdueshme për të dhënë këshillat e nevojshme përmes këshilltarëve të vet, të cilët kanë qenë të përkushtuar në ofrimin e praktikave të vendeve më të zhvilluara, të cilat kanë pasur suksese të dukshme në luftën kundër korrupsionit dhe keq menaxhimit policor.

Duke parë një gatishmëri për bashkëpunim nga ana e kësaj organizate, IPK-ja ka vendosur në njërin nga objektivat strategjike të saj edhe thellimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm me këtë organizatë.



Qendra e trajnimit, ILEA Hungari ku kanë ndjekur trajnimin edhe dy pjesëtar të IPK-së me përkrahjen e ICITAP-it

b) Bashkëpunimi me OSBE-në

Marrëdhëniet e agjencisë me Misionin e OSBE-së në Kosovë janë marrëdhënie të ndërtuara nga viti 2006. Kjo organizatë që nga atëherë kur ka kontribuar në nxjerrjen e bazës ligjore dhe implementimin e Programit për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të IPK-së, gjatë tërë kohës ka vazhduar të mbështesë punën e agjencisë.



Marrëdhëniet vazhdojnë të jenë të natyrës këshillëdhënëse, nga të cilat IPK-ja ka dobi si në aspektin e këshillëdhënës, po ashtu edhe në përfitimin e trajnimeve, donacioneve dhe shërbimeve tjera.

Në drejtim të mbështetjes në nxjerrjen e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në, kontributi i OSBE-së ka qenë evident. Përfaqësuesi i saj ka marrë pjesë aktive në punimet e grupit punues për nxjerrjen e udhëzimeve administrative.



Zv. Ministri i Punëve të Brendshme, Ambasadori i OSBE-së dhe Kryeshefi ekzekutiv i IPK-së gjatë promovimit të fushatës së sensibilizimit të opinionit publik me punën e IPK-së

OSBE përmes përfaqësuesve nga Departamentit për Rend dhe Siguri ka ofruar për agjencinë tonë një numër trajnimesh të cilat kanë ngritur kapacitetet profesionale të punonjësve. Gjatë vitit 2011, OSBE-ja ka organizuar trajnimet, si në vijim: “Trajnimi i menaxhimit të projekteve”, “Zhvillimi i planifikimit strategjik” dhe “Trajnimi kundër korrupsionit”.

OSBE-ja ka lansuar një fushatë promovuese për të sensibilizuar aktivitetet e agjencisë dhe për të njoftuar qytetarët me të drejtat e tyre në raste të ballafaqimit me keqpërdorim të autorizimeve policore.

Fushata ka pasur për qëllim promovimin e autorizimeve të IPK-së për të hetuar rastet e veprave penale kundër punonjësve të policisë, pjesën e hetimeve disiplinore të IPK-së, inspektimin e fushave të menaxhmentit policor, si dhe njoftimin e qytetarëve mbi procedurën për ankesat ndaj sjelljeve të këqija kundër punonjësve policorë.



Qëllimi i fushatës ka qenë që të promovohet IPK-ja si një mekanizëm civil dhe i pavarur i mbikëqyrjes policore, si dhe të rrisë besimin publik në Polici. Fushata ka përfshirë produksionin e një TV spoti dhe një radio spoti, shtypjen dhe vendosjen e posterëve dhe emetimin e spoteve në TV dhe radio stacione.

c) Bashkëpunimi me SHKB-në

Bashkëpunimi me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Shqipërisë (SHKB) ka qenë i një rëndësie të veçantë. Duke qenë agjenci partnere në luftimin e korrupsionit dhe keq menaxhimit policor, edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi reciprok në drejtim të shkëmbimit të përvojave.



Vizitë pune e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së ne SHKB ne Shqipëri

Në SHKB janë realizuar dy vizita pune, njëra është realizuar në qershor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga MPB-ja, IPK-ja dhe ICITAP-i. Vizita e dyte është realizuar në korrik nga përfaqësuesit e Departamentit të Inspektiveve, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit si dhe shkëmbimin e përvojave të dy agjencive. Në të dy vizitat e realizuar, delegacionet janë pritur nga udhëheqësit më të lartë të Ministrisë së Rendit dhe SHKB-së.

f) Bashkëpunimi me EULEX-in

Misioni Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit tashmë ka të angazhuar monitoruesit e saj edhe në IPK. Bashkëpunimi vlerësohet të jetë i nivelit të lartë. Monitoruesit e këtij misioni kanë vënë linjat e përbashkëta të bashkëpunimit fillimisht me dy departamente operative, atë të Hetimeve dhe atë të inspektiveve.



Veç rolit monitorues, punonjësit e këtij misioni gjithashtu kanë luajtur rol të veçantë edhe në dhënien e këshillave, duke ofruar përvojat e tyre në çështjet me interes të dyanshëm. Vlen për t'u çmuar kontributi i dhënë në nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe Planit Strategjik të agjencisë.

g) Bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Policinë

Bashkëpunimi me Prokurorinë Publike është i paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore të agjencisë dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje shumë të ngushta bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit në polici. Me kërkesën e menaxhmentit të IPK-së drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit është caktuar një Prokuror i veçantë për të punuar me IPK-në.



Bashkëpunimi i këtillë është krijuar edhe me Policinë e Kosovës. Bashkëpunimi është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës teknike operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Është e njohur se IPK-ja ka të drejtë të përdorë një numër burimesh të organizatës policore, deri në momentin kur agjencia krijon kushtet e mjaftueshme për punë.

f) Bashkëpunimi me ARTC-në (Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Advokim)

Bashkëpunimi me këtë organizatë zë fill që nga pjesëmarrja e agjencisë në një konferencë që është ndërlidhur me sistemin e ankesave të qytetarëve në organet e ndryshme të drejtësisë dhe zbatimit të ligjit. IPK-ja ka shfrytëzuar rastin në këtë konferencë për të njoftuar pjesëmarrësit e saj lidhur me punën e agjencisë dhe sistemin e parashtrimit të ankesave nga ana e qytetarëve.



Kjo organizatë tani është dukë punuar që në bashkëpunim me IPK-në të nxjerrë një broshurë përmes së cilës synohet që të njoftohen qytetarët e vendit për punën e institucionit tonë dhe për mënyrën e paraqitjes së ankesave në rastet kur kemi të bëjmë me keqpërdorim të autorizimeve policore.

g) Marrëdhëniet me mediet dhe publikun

Aktivitetet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun janë përqendruar në takimet me qytetarë e gazetarë, konferenca dhe njoftime për shtyp dhe fushata promovuese. Për iniciativat dhe aktivitetet e IPK-së ka pasur një interesim të madh, si nga gazetarët, ashtu edhe nga publiku, ku është demonstruar një gatishmëri për të bashkëpunuar ngushtë në luftën kundër fenomeneve negative si, korrupsioni dhe krimi i organizuar.



Duke qenë e përkushtuar në ngritjen e transparencës në raport me qytetarët, IPK-ja ka realizuar disa paraqitje publike. Janë realizuar intervista me Rrjetin "BIRN" ("Drejtësia në Kosovë") dhe emisionet u kanë ofruar mundësi qytetarëve për t'u informuar me aktivitetet e agjencisë.



Mediumet kanë dhënë kontribut të çmuar edhe në promovimin e vlerave të agjencisë. Konferenca nismëtare për shtyp për të shpallur dhe shpjeguar fushatën përmes spoteve televizive e radiofonike dhe posterëve është organizuar më 12 dhjetor 2011 me bashkëpunim të OSBE-së, MPB-së dhe IPK-së në mjediset e MPB-së.



Fushata promovuese për agjencinë e sponsoruar nga OSBE-ja është realizuar prej 12 deri më 25 dhjetor 2011. Kontributi i medieve është për t'u çmuar ngase ndarja e hapësirës publicitare për IPK-në ka ofruar një mundësi të artë për të promovuar vlerat e saj.



Spoti televiziv me kohëzgjatje prej 30 sekondash është emetuar nga së paku tre (3) herë në ditë, për dy (2) javë me radhë në secilën nga këto

stacione: RTK, KTV, RTV21, TV Puls, TV Herc, TV Mir, TV Prizreni, TV Festina dhe TV Syri. Spoti në radio me kohëzgjatje prej 55 sekondash është emetuar nga pese (5) herë në ditë, për 30 ditë me radhë, në secilën nga këto stacione: Radio Vala Rinore, Radio KIM dhe Radio Herc. Dyzetë (40) posterë janë dizajnuar, shtypur dhe vendosur në qendra të ndryshme të Kosovës për 14 ditë me radhë.

Intervistat me mediumet televizive, si RTK-në, Klan Kosova dhe RTV21 po ashtu janë realizuar me qëllimin që opinioni publik të njoftohet me fushatën senzibilizuese mbi punën e IPK-së.

Rol me rëndësi në njoftimin e publikut me punën tonë ka luajtur edhe faqja zyrtare elektronike e cila ka qenë një dritare e hapur për të gjithë ata që kane qenë të interesuar për aktivitetet tona.

Kësaj i është kushtuar rëndësi meqë menaxhmenti ka vlerësuar se ajo mund të jetë një adresë e duhur ku qytetarët do të mund të njoftohen për aktivitetet e agjencisë dhe mundësitë e tyre për të shprehur shqetësimet e tyre.



VIII. PËRMBLEDHJE

IPK-ja me mandatin e ri pretendon që të jetë një lider i njohur në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës, të cilat ajo pretendon ti arrijë përmes ngritjes profesionale dhe shtimit të aktiviteteve planifikuese.

Tani, IPK-ja ka përgatitur edhe Planin Zhvillimor Strategjik 2012-15, përmes të cilit ajo synon që, duke vendosur dhe ruajtur standardet më të larta profesionale në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së, të arrij që të përmbush qëllimet e saj strategjike.

Qëllimi i parë dhe më i rëndësishëm strategjik të cilën IPK-ja i ka përcaktuar veti është që IPK do të jetë një lider i njohur në zbatimin e mandateve ligjore për të parandaluar keq-menaxhimin, korrupsionin dhe aktivitetet tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës.

Këtë qëllim IPK-ja synon që të arrij duke vendosur dhe ruajtur standardet profesionale gjatë zbatimit të mandateve dhe duke hartuar dhe përcjellë planet mujore dhe vjetore për zbatueshmërinë e Mandateve Ligjore për secilin sektor, departament dhe program të veçantë.

- *Departamenti i Inspektimeve; Planifikimi i katër inspektimeve në katër fusha të menaxhmentit në PK-së*
- *Departamenti i Hetimeve; Planifikimi për menaxhimin e hetimit të rasteve duke zoogëluar kohën për zgjedhjen e rasteve*
- *Finalizimi i Departamentit i Testit të Integritetit dhe Planifikimi i Katër planeve operative për teste integriteti)*
- *Departamenti për menaxhimin e ankesave dhe analizimin e informatave; Planifikimi i themelimit të këtij departamenti.*
- *Departamenti i Administratës; planifikimi i menaxhimit të mbështetjes së kërkesave logjistike, administrative dhe financiare për departamentet Operative*

IPK-ja do të përqendrohet për të siguruar shërbim të shkëlqyer për qytetarët, për aktorët-partnerët e saj të jashtëm dhe të brendshëm përmes një shërbimi ndaj konsumatorëve I cili do të jetë – i kompletuar, konciz, korrekt, i kujdesshëm, i kryer me përkushtim, i kryer me mirësjellje, dhe i qartë.

Përmes përpjekjeve efektive, gjatë komunikimit në terren, IPK-së do ti siguroj qytetarëve dhe palëve të interesuara informacione relevante, në kohë dhe të rifreskuara. Ne do të sigurohemi që Ankesat e qytetarëve, Informacionet nga Qendrat e Thirrjes dhe stafi që është përgjegjës për menaxhimin e këtyre ankesave dhe informacioneve të janë të pajisura në mënyrë optimale për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive në kërkesat e qytetarëve.



**Keni ankesë në lidhje
me sjelljen e policisë?**

THIRRNI
INSPEKTORATIN POLICOR TË KOSOVËS
044 192 911

NE JEMI AGJENCI E PAVARUR PËR MBIKËQYRJE POLICORE.
TË GJITHA THIRRJET JANË KONFIDENCIALE.

supported by



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo